



BASHKIA  
TIRANË

**Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve ekonomik “Alko Impex General Construction”  
Degë e shoqërisë së huaj & “Alko Impex Construction” shpk**

**Adresa: Rruga “Reshit Petrela”, Kompleksi Usluga, kati i 8, pranë stacionit të trenit,  
Tiranë.**

### **FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar” “Shërbimi i  
Pastrimit të Tiranës”, Loti III: “Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana III”**

**Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Shërbimi i Pastrimit të  
Tiranës”, Loti III: “Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana III”.**

**Numri i referencës së procedurës/lotit: Ref-80608-12-01-2020**

**Fondi limit në total: 2,787,613,252** (dy miliard e shtatëqind e tetëdhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e trembëdhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

**Fondi limit Loti III: 772,477,256** (shtatëqind e shtatëdhjetë e dy milion e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

**Burimi i financimit:** vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë së Tiranës.

**Kohëzgjatja e kontratës:** Afati maksimal i realizimit të shërbimit do të jetë 3-vjecar. Operatorët ekonomik të shpallur fitues (per secilin Lot) do të rinovojnë kontratat objekt të kësaj Marrëveshje Kuadër çdo 1 (një) vit.

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 25.01.2021, ora 11:00**

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 115 datë 07.12.2020.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

**1.Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk**

**NUIS K71401004W**

Vlera e ofertës = **0** (zero) lekë.

**2. Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” shpk**

**NUIS K91413010N**

Vlera e ofertës = **0** (zero) lekë.

**3. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Victoria Invest” shpk & “Duka” shpk**

**NUIS K32712206U & NUIS J77411203S**

Vlera e ofertës = **696,285,790.95** (gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milion e dyqind e tetëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë pikë nëntëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

**4. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Alko Impex General Construction” Degë e shoqërisë së huaj & “Alko Impex Construction” shpk** NUIS K91326028I & NUIS K91628013D

Vlera e ofertës = **753,947,387.40** (shtatëqind e pesëdhjetë e tre milion e nëntëqind e dyzetë e shtatë mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë pikë dyzetë) lekë pa TVSH.

**5. Operatori ekonomik “Fusha” shpk**

**NUIS J61922018S**

Vlera e ofertës = **772,096,222.05** (shtatëqind e shtatëdhjetë e dy milion e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e njëzetë e dy pikë zero pesë) lekë pa TVSH.

**Janë s’kualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:**

**Përkatesisht për arsyet e mëposhtme:**

**1. Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk**

**NUIS K71401004W**

- Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk ka paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik vetëm Vërtetimin e Debisë me Nr10326/1 Prot. datë 17.11.2020.

Mungesa e dokumentacionit të plotë ligjor, ekonomik dhe teknik u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53, pika 3 dhe pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar) si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu VII, Neni 66, pika 3, KVO e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

**2. Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” shpk**

**NUIS K91413010N**

- Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” shpk ka paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik vetëm Ekstraktin e Regjistrit Tregtar.

Mungesa e dokumentacionit të plotë ligjor, ekonomik dhe teknik u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53, pika 3 dhe pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar) si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu

VII, Neni 66, pika 3, KVO e shpall **të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

### **3. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Victoria Invest” shpk & “Duka” shpk**

**NUIS K32712206U & NUIS J77411203S**

- Shoqëria “Duka” shpk ka deklaruar si shërbim të ngjashëm kontratën me objekt “*Shërbim i pastrimit urban të qytetit të Vlorës*”. Pas verifikimit të dokumentacionit shoqëruës për përvojën e ngjashme rezulton se Shoqëria “Duka” shpk nuk ka paraqitur Vërtetim nga fushë depozitimi mbi depozitimin e mbetjeve, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit Loti III, Kapaciteti Teknik, pika 1.2.
- Shoqëria “Duka” shpk ka paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik ISO 9001-2015 të pavlefshme, pasi i ka përfunduar afati i vlefshmërisë më datë 20.11.2020, ndërkohë që data e zhvillimit të procedurës së prokurimit ka qenë data 06.01.2021. Për sa më lart, Shoqëria “Duka” shpk nuk plotëson DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit Loti III, Kapaciteti Teknik, pika 3.
- Shoqëria “Duka” shpk ka paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik ISO 14001-2015 të pavlefshme, pasi i ka përfunduar afati i vlefshmërisë më datë 20.11.2020, ndërkohë që data e zhvillimit të procedurës së prokurimit ka qenë data 06.01.2021. Për sa më lart, Shoqëria “Duka” shpk nuk plotëson DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit Loti III, Kapaciteti Teknik, pika 4.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomik ka deklaruar sipas Shtojcës 7/2, se disponon mjete sipas Kontratës së Porosisë, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit Loti III, Kapaciteti Teknik, pika 9, gërma “a” dhe gërma “b”, ku disponimi i mjeteve parashikohet vetëm nëpërmjet Kontratës së Shitjes apo Kontratës së Qerasë.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provojë disponimin e konteniereve të kërkuara sipas pikës 10 të DST. Bashkimi i Operatorëve ekonomik ka paraqitur vetëm një Kontratë Porosie për kontenieret, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit Loti III, Kapaciteti Teknik, pika 10, gërma “a” dhe gërma “b”, ku disponimi i konteniereve parashikohet vetëm nëpërmjet Kontratës së Shitjes apo Kontratës së Qerasë.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Bashkimin e Operatorëve ekonomik “Alko Impex General Construction” Degë e shoqërisë së huaj & “Alko Impex Construction” shpk**, me adresë: *Rruga “Reshit Petrela”, Kompleksi Usluga,kati i 8, pranë stacionit të trenit, Tiranë*, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **753,947,387.40** (shtatëqind e pesëdhjetë e tre milion e nëntëqind e dyzetë e shtatë mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë pikë dyzetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **772,096,222.05** (shtatëqind e shtatëdhjetë e dy milion e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e njëzetë e dy pikë zero pesë) lekë pa TVSH, siç parashikohet në Nenin 58, pika 5 të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar).

**Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 03.02.2021**

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, është një ankesë pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, është paraqitur Formulari i Ankesës në lidhje me vlerësimin për procedurën e prokurimit me objekt: **“Shërbimi i Pastrimit të Tiranës”, Loti III: “Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana III”**, hyrë në Bashkinë e Tiranës me shkresën me Nr. 6456 Prot. datë 09.02.2021. Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, ka ndjekur të gjitha procedurat ligjore në lidhje me trajtimin e ankimeve dhe nëpërmjet shkresës me Nr. 6456/4 Prot. datë 11.02.2021 ka konkluduar me mospranimin e Formularit të Ankesës.

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankimeve pranë Komisionit të Prokurimit Publik në mbështetje të Nenit 63, pika 6 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), nuk u paraqit asnjë ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.